Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	**Fakulteti i Arteve te Aplikuara**
Titulli i lëndës:	Grafikë Reklamuese I
Niveli:	**Bachelor**
Statusi lëndës:	**Obligative**
Viti i studimeve:	**2**
Numri i orëve në javë:	**3**
Vlera në kredi – ECTS:	**6**
Përshkrimi i lëndës	Kjo lëndë trajton parimet, metodat dhe teknikat e dizajnimit të paketimit dhe ambalazhimit të produkteve industriale. Studentët do të mësojnë si të planifikojnë ambalazhimin duke marrë parasysh buxhetin, sistemin dhe variantet e produktit, zgjedhjen e materialeve, rifreskimin e brendit, përdorimin e ngjyrave, fotografisë dhe stilit vizual. Lënda përfshin gjithashtu dizajnimin sipas kërkesave të tregut, ambalazhimin për produkte specifike si pije, verë, birrë dhe produkte për fëmijë, përgatitjen e dhuratave, si dhe sistemet e mbylljes dhe paketimit.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është që studentët të përvetësojnë njohuritë dhe aftësitë praktike mbi dizajnin grafik të aplikueshëm në produktet industriale, duke përfshirë realizimin e ambalazheve funksionale dhe estetike sipas nevojave të tregut.
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studenti do të jetë në gjendje të: • Njohë dhe përdorë parimet, mjetet dhe teknikat e realizimit të dizajnit grafik për produktet industriale. • Analizojë produktin dhe të planifikojë ambalazhimin sipas kërkesave specifike. • Kuptojë dhe të realizojë etiketa, ambalazhe dhe dizajne të përshtatura për produktet industriale. • Zbatojë parimet dhe teknikat e dizajnimit të ambalazhit në mënyrë profesionale dhe funksionale.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	**Orë**	**Ditë/javë**	**Gjithësej**
Ligjërata	2	14	28

Ushtrime teorike/laboratorike	2	14	28
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	2	2	4
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë	3	14	42
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	14	42
Përgaditja përfundimtare për provim			
Koha e kaluar në vlerësim **(teste, kuiz, provim final)**	2	1	2
Projektet, prezentimet, etj	4	1	4
Totali			**150**
Metodologjia e mësimëdhënies:	Ligjërata, punë individuale, detyra, diskutime, punë në grupe dhe mësimdhënie e bazuar në projekte (project-based learning).		
Metodat e vlerësimit:	80% Punime Praktike 20% Prezantim		
Literatura			
Literatura bazë:	Grip, Best Practices for Graphic Designers, Packaging: An essential guide for implementing effective package design solutions, Rockport Publishers, 2013.		
Plani i dizajnuar i mësimit:			
Java	**Ligjërata që do të zhvillohet**		
Java e parë:	***Ngjyrat dhe teoria e tyre në dizajnin grafik.***		
Java e dytë:	***Dizajnimi i një posteri***		
***Java e tretë*:**	***Rëndësia e tipografisë***		
Java e katërt:	***Dizajnimi i një etikete për pije.***		
Java e pestë:	***Projektimi i paketimit të ushqimeve: parimet bazë dhe analiza e tregut.***		
***Java e gjashtë*:**	***Dizajnimi praktik i paketimit të ushqimit.***		
Java e shtatë:	***Prezantimi dhe finalizimi i produktit: analiza kritike dhe feedback.***		
Java e tetë:	***Përsëritje dhe integrimi i njohurive të fituara.***		
Java e nëntë:	***Dizajni i etiketës për shishen e ujit***		
Java e dhjetë:	***Rifreskimi i markës: strategjitë për riformulim vizual.***		
***Java e njëmbedhjetë*:**	***Ndryshimi dhe modernizimi i logos***		

***Java e dymbëdhjetë*:**	***Dizajnimi i produkteve nga qumështi***
***Java e trembëdhjetë*:**	***Dizajnimi i qumështit dhe paketim funksional.***
***Java e katërmbëdhjetë*:**	***Dizajni i kosit dhe paketim funksional.***
***Java e pesëmbëdhjetë*:**	***Dizajni i djathit dhe paketim funksional.***
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:	
Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.	